# DËSHMI ARKIVI

**A-446156**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rreth 4 mijë kredi për çiftet e reja/ Shteti garanton huanë pa parapagim, 2 mijë kuota me interes zero në 2027 |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/15/rreth-4-mije-kredi-per-ciftet-e-reja-shteti-garanton-huane-pa-parapagim-2-mije-kuota-me-interes-zero-ne-2027/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 13:19:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 15 shtator 2026, 13:18:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 15 shtator 2026, 13:17:00 UTC → 15 shtator 2026, 13:19:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `6bd33f804a8610080188130599ce4b5b17e8409ec6f598bcc9be4d1908fd1341` |
| TEKSTI | `0250b002dc510bcf722245549d6ab3f5e3cd025c46448aac76c4d23fffee7ee8` |
| PAMJA | `ed24e5f589145f3523ebc9fedfb071a46c47687c68ed77ac805b046242f16174` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `4ea7f2ffc2d7b20963d9a55dddc47ea0af63ca00c1f9a3d7c8118c0309ac39fd` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7b60020d12239b3c3f63032b973e8451536e9d643adb77567035503a03c510f7` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/4ea7f2ffc2d7b20963d9a55dddc47ea0af63ca00c1f9a3d7c8118c0309ac39fd`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

EKONOMI TË FUNDIT

# Rreth 4 mijë kredi për çiftet e reja/ Shteti garanton huanë pa parapagim, 2 mijë kuota me interes zero në 2027

15/09/2026 15:18



**Të blesh shtëpinë e parë, pa pasur nevojë për një parapagim dhe me kredi të lehtësuar nga shteti është mundësia që programi i ri i strehimit synon t'u japë mijëra të rinjve.**

Për Top Channel drejtoresha e strehimit Social, Dardana Grabova shpjegon kriteret për përfituesit dhe si do të bëhet përzgjedhja.

*"Aplikimin për këto kuota do ta kenë padyshim në vend të parë familjet e reja, të rinjtë, pasi në fokus është ndërtimi dhe krijimi i familjeve. Por kategoria e 4,000 kredive është ndarë në dy kategori të ndryshme, ku janë 2,000 kuota për kredi me 0% dhe 2,000 kuota me interes 3%. Që do të thotë që ajo çfarë është me 0% është deri në masën 60,000 euro apo 6 milionë lekë të reja, dhe mbi 6 milionë lekë të reja kalon me interes 3%", tha drejtoresha e strehimit social, Dardana Grabova.*

Por në kushtet e çmimeve aktuale të banesave, sa realiste është të gjesh një apartament të përshtatshëm brenda këtij kufiri, sidomos në Tiranë?

*"Në fakt e kam e kam vënë re edhe në disa mediat sociale të cilat dedikojnë dhe thonë faktin që ku do të gjesh ti me 60,000 euro një banesë, pasi çmimet sot janë rritur. Në fakt, ne nuk e kemi kufizuar një familje të re apo një të ri të gjejë një banesë vetëm në atë vlerë. Jo, e nëse ti e gjen atë edhe në 8 milionë, 9 milionë, 10 milionë lekë të reja, automatikisht ti do të jesh përfitues, por do të kesh masën e interesit 3%, pra jo zero. Nëse ne shikojmë jashtë unazës, padyshim që ka apartamente, qofshin ato studio, garsoniere, mansardë në gjuhën teknike, janë apartamente të cilat apo dhe private qofshin ato, ka plot banesa të cilat janë të raportuara që mund të gjesh. Pra ne nuk kemi kufizuar në mundësinë e gjetjes së banesës. Çdo familje e re dhe i ri ka të drejtën që të gjejë shtëpinë aty ku e gjen të përshtatshme, ama diferenca ndërmjet njërës dhe tjetrës do të jetë masa e interesit, nga zero në 3", tha Grabova.*

Të rinjtë nuk do të kenë nevojë për parapagim teksa shteti do të marrë përsipër edhe garancinë që kërkohet nga banka. Përballë një numri aplikimesh që pritet të jetë më i lartë se kuotat, do të funksionojë sistemi i pikëzimit, ku rëndësi do të ketë gjendja familjare, mungesa e banesës dhe përbërja e familjes.

*"Pa dyshim që sistemi i pikëzimit do të jetë shumë i zgjeruar, familjet e reja mund të jenë familje të reja me një fëmijë, me dy fëmijë, me tre fëmijë, një nga kategoritë prioritare është ata që nuk kanë banesë. Pra do jenë një tërësi kategorish të cilat do bëjnë të mundur... arritjen te 4000 kuotat e vendosura vetëm për vitin 2027", u shpreh drejtoresha.*

Përfituesit duhet të jenë të regjistruar në bashkinë ku do të marrin kuotën ndërsa programi nuk synon blerjen e një banese të dytë, por banesën e parë ose një shtëpi që nuk plotëson normat e strehimit.

## Kryesore




"Do të vras po tregove"/ Rrëfimi tronditës i 34-vjeçares nga Roskoveci: Daja i deputetes Zegjine Çaushi më rrëmbeu dhe përdhunoi, më premtoi punë se njihte shefat
14:57

Dosja "Revanshi"/ GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tjerë
09:32

Cënuan perimetrin e sigurisë në shkolla gjatë tubimit të djeshëm, arrestohen 12 protestues, procedohen 15 të tjerë
10:39

Vuçiç zbulon datën e dorëheqjes, presidenti i Serbisë: Fushatën e vazhdoj si qytetar i thjeshtë
11:34

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City
09:50

## Më të lexuarat

Gjykata e Lartë merr vendimin për Veliajn, kryebashkiaku mbetet në burg

25 mijë euro vetëm pishina/ Email-et dhe dokumentet në dosje, SPAK ia atribuon vilën Belinda Ballukut. Heshtin "Atelier 4" dhe "Green Coast"

Mbretëria e Bashkuar po dridhet/ Skocia, Uellsi dhe Irlanda e Veriut kërkojnë referendum: E ardhmja jonë është në BE

Tensionet zhvendosen në hapësirë, SHBA pranon se ka armë në orbitë: Rusia dhe Kina konsiderohen kërcënimet kryesore

"China Zorrilla", anija më e madhe elektrike në botë mbërrin në Uruguai, nis udhëtimet në tetor

Ekskluzive/ Maran hap listën e madhe, rreth 50 ftesa për Kombëtaren, mes tyre 3 lojtarë të Dinamo City

"FBI kishte mijëra përgjime për Al Caponen, por s'kishte prova", Filip Çakuli: Veliajn e arrestuan nga thashethemet, e linçuan publikisht

"Korrupsion, dy vila të fshehura si rryshfet dhe 8 akuza për tenderat", analisti Sulo ngre alarmin: Ç'po ndodh me SPAK? Askush me këto akuza s'i ka shpëtuar arrestit

Vendimi 3 me 0 ndaj Veliajt/ Gjykata e Lartë

Krahas kredisë 3 mijë familje do të mund të përfitojnë edhe subvencionim të qirasë, me shtetin që mbulon 50% të kontratës ndërsa për studentët dhe të rinjtë parashikohet një tjetër mundësi përmes platformës së re.

*"Do të krijojmë një platformë e cila do të bëjë të mundur regjistrimin e atyre qytetarëve të cilët disponojnë banesa në pronësi... këto të merren nga individët si studentët, të rinjtë, familjet e reja dhe të pajisen me bonusin e qirasë 50% të vlerës", përfundoi drejtoresha.*

Programi parashikohet të nis në vitin 2027.

**Top Channel**


la në fuqi Apelin, ja çfarë thoshte një vit më parë për paraburgimet

Dosja "Revanshi"/ GJKKO shpall vendimin, 50 vite burg për Durim Bamin dhe gjashtë të pandehurit e tjerë


## Ekonomi »



**Rekord remitancash në 6 muaj, emigrantët ju dërguan familjeve rreth 621 milionë euro në gjysmën e parë të vitit**

15/09 12:45



**Rekord parash nga emigrantët, 621 milionë euro në gjashtë muaj, por kursi i këmbimit ua zbeh vlerën**

14/09 20:15



**"Bashkitë të përthithin projekte", kreu i BERZH për Top Channel: Për integrimin Shqipëria duhet të zgjerojë projektet në nivel vendor**

13/09 18:45



**Taksat në naftë mbushin arkën e shtetit, më shumë para në buxhet nga shtrenjtimi, 1.7 miliardë lekë më tepër që nga marsi**

13/09 12:29



**Rekord investimesh të huaja/ 1.1 miliardë euro në gjashtë muaj, projekti i Zvërnecit shton flukset hyrëse**

11/09 15:10



**Program i ri për strehimin, Qeveria prezanton 6 skema për familjet e reja dhe shtresën e mesme, 4 mijë përfitues**

10/09 19:58

## Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



**Top News – 'Malli' gati për shitje/ Kapet i riu në Durrës me qindra doza kokaine**



**Top Channel/ 4 mijë kredi për çiftet e reja. Shteti garanton huanë pa parapagim**



**Top Channel/ PD: Të ulen taksat e naftës: Diezeli 229 lekë litri, 30% mbi mesataren e rajonit**



**Top Channel/ Hapet konsullatë shqiptare në Napoli. Shkon edhe Rama, viziton katedrën e gjuhës shqipe**



**Top News – Ping-pong me proporcionalitetin, vendimi për Veliajn, GJL e pason te Apeli i Posaçëm**



**Top Channel/ Pagat e gjyqtarëve bashkojnë PS-PD. Manja pranon kërkesën e Bylykbashit**




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.